



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:067784

Datë: 07.03.2022

Numri i dokumentit: 02782622

P.nr. 100/21

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti i Pergjithshem - Divizioni penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, si gjyqtare e vetme gjykuese, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa , në lëndën penale kundër të pandehurit M.K nga Kaçaniku, për veprën penale, vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.493/21 e datës 08.04.2021, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 07.03.2022 merr këtë,

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj PP.nr.493/21 e datës 08.04.2021, e parashtruar kunder te pandehurit M.K nga Kaçaniku, per shkak te dyshimit se:

Me datë 12.01.2021 dhe 01.10.2020 në Kacanik rr “Burim Rexha “ saktësisht ne shtëpinë e tij me anë të lajthimit siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm ne shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, ashtu që me rastin e kontrollit nga personat e autorizuar të ..., është konstatuar se i pandehuri dhe pse ka qenë i ç’kyqur nga distanca, i njëjti ka bërë lidhje direkte ne rrjetin elektrik dhe në këtë mënyrë është furnizuar pa matje, deri sa energjia elektrike nuk është regjistruar fare në njehsorin elektrik me numër ... (grupi tarifar 4 /02 shtepiak) me ç’rast i ka shkaktuar kështu të dëmtuarës ..., dëm material në vlerë prej 423.57 € .

Me çka do të kryente veprën penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka parashtruar para kesaj gjykate aktakuzen PP.nr.493/21 e datës 08.04.2021, kundër të pandehurit M.K nga Kaçaniku, per vepër penale , vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke u përgatitur për caktimin e shqyrtimit gjyqesor, ne bazë te vërtetimit për vdekjen e lëshuar nga QKUK-së, Klinika e Kardiologjisë-Njësia Koronare e dt. 30.12.2021 dhe certifikata e vdekjes nr. ..., nr.i references 19/2022RV/19001 lëshuar në Prishtinë me dt. 24.02.2022, konstatoi se i pandehuri M.K nga Kaçaniku, ka vdekur me dt.... në Prishtinë.

Andaj gjykata, bazuar në dokumentet e lartëcekura, konstatoi se i pandehuri M. (Xh...) K. nga Kaçaniku, ka vdekur me dt.... në Prishtinë.

Meqenëse vdekja e te pandehurit eshte pengesë për ndjekje penale, gjykata vendosi që t'a Hudh aktakuzën.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 454 par.1 të KPRK,se

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr. 100/21 datë 07.03.2022

Sekretarja Juridike ,
Indira Beqa,

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.